



Datë: 12.02.2026

Numër Protokolli: 785/2026

A.nr.2079/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti-Kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Flakron Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.2079/2025 të datës 29.12.2025 të parashtruar nga ankuesja V.Z.I, kundër Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 12.02.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.2079/2025, e datës 29.12.2025 e parashtruar nga ankuesja V.Z.I.

II. Mbetet në fuqi Formulari i Komisionit të Pranimi të datës 26.11.2025 për vlerësimin përfundimtar të testit me shkrim dhe intervistës me gojë, për pozitën “Mbikëqyrës i Sektorit për Pranim, Regjistrim, Dorëzim dhe Menaxhim të Lëndëve” në Gjykatën Themelore në Ferizaj.

A r s y e t i m

Kandidatja në procedurë të pranimi, V.Z.I (në tekstin e mëtejme referuar: ankuesja) me datë 25.12.2025 përmes postës elektronike ka parashtruar ankesë e cila në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për të cilën pala është udhëzuar të plotësoj për shkak të lëshimeve teknike, dhe pastaj ankesa është regjistruar me datë 29.12.2025 me numër protokolli 8099/2025 nën shenjë A.nr.2079/2025, kundër procedurës së rekrutimit për pozitën “Mbikëqyrës i Sektorit për Pranim, Regjistrim, Dorëzim dhe Menaxhim të Lëndëve” në Gjykatën Themelore në Ferizaj, të shpallur nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 31.12.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ndërsa kjo e fundit më datë 15.01.2025 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës, ndërsa për kërkesës për prova shtesë kjo e fundit ka ofruara prova dhe sqarime shtesë me datë 06.02.2026.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën me numër protokollit 8099/2025 të datës 29.12.2025 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin e rezultateve përfundimtare të kandidatëve i datës 26.11.2025; Kopjen e ID-së së ankueses; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 31.12.2025; Përgjigje në kërkesë e datës 15.01.2026; Njoftimi i fazës së verifikimit paraprak i datës 10.11.2026; Njoftimi i datës 24.11.2026; Vendimi i datës 17.11.2025 i Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të KGJK-së me akt emërimet e anëtarëve të komisionit; Njoftimi i datës 14.11.2025; Çelësi i pyetjeve të testit me shkrim; Rezultatet e intervistës me gojë i datës 26.11.2025; Konkursin e datës 23.10.2025; Udhëzues i testit me shkrim i datës 20.11.2025; Testi me shkrim i ankueses; Formulari i vlerësimit të intervistës me gojë për ankueses; Aplikacioni i ankueses i datës 31.10.2025 me dokumentacionin e bashkangjitur; Formularët e intervistës me gojë për candidate e suksesshme; Aplikacioni i kandidatës së suksesshme i datës 04.11.2025 me dokumentacionin e bashkangjitur; Kërkesën e datës 04.02.2026; Përgjigjen e datës 06.02.2026; Deklaratat e datës 05.02.2026 anëtarëve të Komisionit të Pranimit; Deklaratën e anëtarit A.H e datës 19.11.2025; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën ne procedurë rekrutimi.

Kolegji i Këshillit, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës nga palët në këtë procedurë administrative, ka konstatuar se ankesa e ankueses është ***e pabazuar***, sepse:

Kolegji i Këshillit, nga administrimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe Rregullores Nr.01/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Pranimit, Emërimit dhe Punës Provuese për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor, me datë 23.10.2025 ka shpallë konkursin e pranimit (i brendshëm) për pozitën “*Mbikëqyrës i Sektorit për Pranim, Regjistrim, Dorëzim dhe Menaxhim të Lëndëve*” në Gjykatën Themelore në Ferizaj, ndërsa bazuar në shkresat e lëndës ankuesja e ka kaluar fazën e verifikimit paraprak dhe në të njëjtën kohë iu është nënshtruar procedurave të tjera të rekrutimit.

Tutje, sipas Formularët e vlerësimit përfundimtar të testit me shkrim dhe intervistës me gojë, të datës 26.11.2025, ankuesja iu ka nënshtruar testimit me shkrim dhe ka marr 60.2 pikë, ndërsa në intervistën me gojë ka marrë 19.5 pikë, ashtu që është renditur si candidate e suksesshme e dyta (2) me radhë me gjithsejte 79.7 pikë, kurse kandidatja e renditur e para (1) me më së shumti pikë rezulton të jetë kandidatja A.T-B me gjithsejtë 82.12 pikë, prej të cilave 56.7 pikë në testin me shkrim, ndërsa 25.42 pikë në intervistën me gojë.

Ankuesja, e pakënaqur me zhvillimin e procedurës së rekrutimit nga SKGJK, respektivisht njoftimit për kandidatët e suksesshëm, sipas udhëzimit në mjete juridike përmes aktit të kontestuar, ka parashtruar ankesë në Këshill për shkak të shkeljeve të dispozitave të Ligjit për Zyrtarët Publik, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të të drejtës materiale, me pretendimin ankimor se me rastin e zhvillimit të intervistës me gojë, më janë parashtruar vetëm tre (3) pyetja, ndërsa janë obligative të parashtrohen pesë (5), sikurse pyetjet e parashtruara janë bërë vetëm nga Kryetari i Komisionit, veprime këto në kundërshtim me Rregulloren Nr.01/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Pranim, Emërimit dhe Punës Provuere për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor, po ashtu me pretendimin ankimor se komisioni përkatës nuk ka marr përbazë trajnimet e prezantuara, sikurse pretendon se gjatë intervistimit nuk ka pasur vëzhgues nga shoqëria civile si dhe komisioni i pranimit nuk ka qenë i themeluar në pajtueshmëri me dispozitat e rregullores përkatëse të rekrutimit, si dhe nenit 39 të LZP-së, me arsyetimin se vlerësimi s'ka qenë profesional.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit dhe rrjedhimisht vlerësimin e ligjshmërisë se procedurës së rekrutimit për pozitën përkatëse, Kolegji i Këshillit, fillimisht ju referua Konkursit/, me numër 03/2025 të shpallur me datën 23.10.2025 për pozitën “Mbikëqyrës i Sektorit për Pranim, Regjistrim, Dorëzim dhe Menaxhim të Lëndëve”, në Gjykatën Themelore në Ferizaj, e për rrjedhojë konstatoi se kriteret e përgjithshme formale të konkursit kanë qenë:

- **Arsimimi i kërkuar** Diplomë Universitare të vlefshme në Kosovë: Fakulteti Juridik;
- **Përvoja e punës** Së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale.

Kolegji i Këshillit, në mbështetje të dispozitave nga nenin 2 paragrafi 3 i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet se: “**2. Fusha e zbatimit**, 3. Për nëpunëset/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, ky ligj zbatohet për atë që nuk cenon pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative të garantuar me Kushtetutë”, andaj edhe mori për bazë aktet e veçanta të legjislacionit sekondar të nxjerrë nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, respektivisht dispozitat e aplikuara të nenit 2 të Rregullores Nr. 02/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës për Nëpunësit Civil në Administratën e Sistemit Gjyqësor, ku përcaktohet se: “*Kjo rregullore përcakton kategoritë dhe klasat e nëpunësve civil të administratës në sistemin gjyqësor, përfshirë emërtesat e pozitave për çdo klasë, grupin, koeficientin, përshkrimin përgjithshëm për secilën kategori dhe klasë, procedurën dhe metodologjinë e klasifikimit pozitave të punës*”, ndërsa me nenin 19, paragrafi 6, nën paragrafi 6.1 të së njëjtës rregullore, është përcaktuar se pozita “Mbikëqyrës i Sektorit për Pranim, Regjistrim, Dorëzim dhe Menaxhim të Lëndëve”, hynë në kuadër të kategorisë Drejtues/i/e Ulët.

Po ashtu, me nenin 19 paragrafi 5 të Rregullores Nr. 02/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës për Nëpunësit Civil në Administratën e Sistemit Gjyqësor, janë përcaktuar edhe çështjet e kërkesave formale, ku përcaktohet se: “Kërkesat e përgjithshme formale: 5.1. *arsimimi i kërkuar: diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor)*; 5.2. *kërkesat specifike: certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitën e kësaj klase*; 5.3. *përvoja*

e punës e kërkuar: së paku tre (3) vite përvojë pune profesionale.”, ndërsa lidhur me përshkrimin e detyrave të punës, Kolegji i Këshillit ka pranuar përshkrimin e detyrave dhe kritereve të aprovuara për pozitën në fjalë, e që përputhen me ato të shpallura në konkursin e datës 23.10.2025 dhe paragrafin 5, neni 19 i Rregullores Nr.02/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës për Nëpunësit Civil në Administratën e Sistemit Gjyqësor, dhe për rrjedhojë Kolegji i Këshillit konstatoi se konkursi i datës 23.10.2025 për pozitën “Mbikëqyrës i Sektorit për Pranim, Regjistrim, Dorëzim dhe Menaxhim të Lëndëve” është shpallur në pajtueshmëri me dispozitat e rregullores në fjalë për Klasifikimin e Vendeve të Punës për Nëpunësit Civil në Administratën e Sistemit Gjyqësor.

Thënë si më lartë, dhe me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit mori për bazë dispozitat nga neni 1 i Rregullores Nr.01/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Pranim, Emërimit dhe Punës Provuese për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor ku përcaktohet se: “*1. Qëllimi i kësaj rregullore është përcaktimi i kritereve, rregullave, themelimi i komisioneve, procedurave për rekrutim, vlerësimin, pranimin, emërimin dhe vlerësimin e punës provuese për të punësuarit në administratën e sistemit gjyqësor në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi. i 2. Dispozitat e kësaj rregullore zbatohen nga të gjitha palët e përfshira gjatë procedurës së rekrutimit, themelimit të komisioneve, vlerësimit, pranim, emërimit dhe vlerësimit të punës provuese për të punësuarit në administratën e sistemit gjyqësor. 3. Përfshirja e paragrafit 2 të këtij neni, dispozitat e kësaj rregullore nuk zbatohen për pozitën: Drejtor i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit, Drejtor i Njësisë për Inspektim Gjyqësor, Drejtor Sekretariatit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa, administratorët dhe zëvendës administratorët e gjykatave si dhe bashkëpunëtorët profesional*” dhe konstatoi se dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen për pozitën “Mbikëqyrës i Sektorit për Pranim, Regjistrim, Dorëzim dhe Menaxhim të Lëndëve” duke përfshirë edhe çështjen e plotësimit të kritereve të përcaktuara si në konkursin përkatës.

Andaj në referencë të konstatimit të dhënë si më lartë, Kolegji i Këshillit mori për bazë dispozitat e nenit 16 paragrafi 1 të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Pranim, Emërimit dhe Punës Provuese për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor, kur përcaktohet se: “*1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidatët për pranim plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit*”, dhe pas analizimit të dosjeve të kandidates së suksesshme për pozitën Mbikëqyrës i Sektorit për Pranim, Regjistrim, Dorëzim dhe Menaxhim të Lëndëve në Gjykatën Themelore në Ferizaj, konstatoi si në vijim, se:

Kandidatja e suksesshme A.T-B sipas Formularit të vlerësimit përfundimtar të testit me shkrim dhe intervistës me gojë, të datës 26.11.2025 për pozitën Mbikëqyrës i Sektorit për Pranim, Regjistrim, Dorëzim dhe Menaxhim të Lëndëve, sipas aplikacionit të datës 28.10.2025 (protokolluar me datë 31.10.2025 dhe shifër 03/45) me dokumentet e bashkangjitura posedon: Diplomën e datës 26.03.2015 përmes së cilës dëshmohet fakti se e njëjta me datë 30.09.2013 ka mbaruar studimet themelore në Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, dhe po ashtu posedon Vërtetimin e datës 29.10.2025 të lëshuar nga Zyra e Personelit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, sipas të cilit dëshmohet fakti se e njëjta nga data 01.07.2015 e deri me datë 30.06.2016 ka punuar me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta në pozitën Sekretare Juridike në Gjykatën Themelore në Ferizaj, ndërsa nga

data 01.03.2017 e tutje është në marrëdhënie pune në pozitën Zyrtare Ligjore në Gjykatën Themelore në Ferizaj, dhe mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit fillimisht konstatoi se kandidatja e suksesshme e renditur e para (1) për nga numri i përgjithshëm i pikëve në konkursin përkatës i ka plotësuar kriteret e përcaktuara si në konkursin e datës 23.10.2025 për pozitën përkatëse.

Lidhur me pretendimet ankimore të palës ankuese, Kolegji i Këshillit mori përbazë përcaktimet ligjore si në nenin 22, paragrafi 2, 4, 6, 7 dhe 9 të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Pranimit, Emërimit dhe Punës Provuese për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor ku përcaktohet se: *“2. Në intervistë, vlerësohen njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara që nuk mund të vlerësohen nëpërmjet testimit me shkrim. 4. Përveç pyetjeve, anëtarët e komisionit të pranimi mund të parashtrojnë edhe nënpyetje për kandidatin me qëllim të vlerësimit më të saktë të kandidatit lidhur me pyetjen kryesore. 6. Intervista për kandidatët për pozitën e kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese, bazohet në kompetencë dhe përmban pesë (5) pyetje të cilat vlerësohen me më së shumti katër (4) pikë, si dhe një (1) pyetje për prezantim e cila vlerësohet me më së shumti 5 pikë. 7. Secili nga anëtarët e komisionit të pranimi bënë vlerësimin e detajuar për secilën pyetje dhe për secilin rast të vlerësimit minimal apo maksimal duhet të jep arsyetim me shkrim. 9. Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin ndahet si vijon: 9.1. deri në dy pikë pesë (2.5) pikë për përvojën relevante në punë më të gjatë se sa ajo që është kërkuar me konkurs; dhe 9.2. deri në dy pikë pesë (2.5) pikë për trajnimet relevante në fushën përkatëse”,* ndërsa Kolegji i Këshillit përmes përfaqësuesit të autorizuar iu drejtua Burimeve Njerëzore të SKGJK-së, me datë 04.02.2026 me kërkesën si në vijim, citoj: *“ për shkak të specifikave të pretendimeve ankimore të ankueses, kërkojmë sqarime dhe prova shtesë: Deklaratë me shkrim nga secili anëtarë i Komisionit të Pranimit, veç e veç, ku secili prej tyre dëshmon se cilën pyetje e ka parashtruar në fazën e intervistës me gojë”* kurse kjo ne fundit me datë 06.02.2026 ka kthyer përgjigjen në të cilën ka bashkangjitur deklaratat e datës 05.02.2026 të dhëna nga pesë (5) anëtarët e Komisionit të Pranimit, sipas të cilave konfirmohet fakti se ankuesja i është nënshtruar pesë (5) pyetjeve të përcaktuara veç e veç, si dhe për secilën pyetje është vlerësuar, ashtu që Kolegji i Këshillit në rrethanat e rastit konkret në procedurën administrative ia fali besimin deklaratave të anëtarëve të komisionit përkatës, sikurse po ashtu nga shkresat e lëndës u konstatua fakti se ankuesja është vlerësuar nga secili anëtarë i komisionit për secilin pyetje sikurse përcaktohet me dispozitat e cekura si më lartë dhe po ashtu me formularët e vlerësimit individual të kandidatit në procedurë të nënshkruar nga anëtarët e komisionit të pranimi, prandaj mbi këtë bazë në procedurën administrative duke vepruar mbi provat e lëndës si dhe deklaratave të dhëna nga anëtarët e Komisionit të Pranimit të datës 05.02.2026, vendosi që të refuzoi pretendimin ankimor të ankueses se e njëjta në intervistën me gojë i është nënshtruar vetëm tre (3) pyetjeve.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankueses, se Komisioni i pranimi nuk ka marr përbazë trajnimet e prezantuara me rastin e intervistimit, me arsyetimin se organi i punësimit është dashur të ketë evidencën e trajnimeve të ndjekura pasi që ankuesja nuk i ka poseduar dokumentet në fjalë, Kolegji i Këshillit thekson faktin se në konkursin e datës 23.10.2025 me shifër 03/2025 në pikën 5 të përmbajtjes ndër tjerash është përcaktuar se: *“Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre- Dëshmitë e trajnimeve profesionale të ndjekura apo trajnimeve që aplikuesi i ka realizuar në cilësinë e trajnuesit”,* prandaj mbi këtë bazë pretendimi ankimor nuk është i bazuar, pasi që sipas përcaktimit të lartcekur në konkurs është në përgjegjësi të kandidatit të paraqes dëshmi dhe

prova mbi kualifikimet apo trajnimet e ndjekura, ndërsa anëtarët e Komisionit të Pranimit mbështeten vetëm në dokumentacionin bashkangjitur nga kandidatët në procedurën me rastin e aplikimit.

Po ashtu, lidhur me përbërjen e Komisionit të Pranimit, Kolegji i Këshilli mori për bazë dhe iu referua nenit 6 paragrafi 1 dhe 2 të ku përcaktohet se: *“1. Vlerësimi profesional i kandidatëve për emërimin në një pozitë të kategorisë së ulët dhe mesme drejtuese në administratën e sistemit gjyqësor bëhet nga komisioni i pranimit. 4 të 2. Komisioni i pranimit për pozita të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese, ka pesë (5) anëtarë të rregullt dhe për secilën kategori të anëtarëve të komisionit caktohet një anëtarë zëvendësues në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunës civil ekzistues të kategorisë së njëjtë apo më të lartë ku njëri nga ta caktohet Kryetar i Komisionit; 2.2. një (1) përfaqësues nga NjMBNj; dhe 2.3. një (1) nëpunës civil me njohuri në fushën e pozitës së lirë”,* kurse me Vendimin Nr:DS-1037/2025 të datës 17.11.2025 Drejtori i Përgjithshëm i SKGJK-së, e ka themeluar Komisionin e Pranimit si dhe ka përcaktuar zëvendësuesit e anëtarëve të komisionit, në këtë përbërje: 1. Astrit Hoti- i cili sipas Aktit të Emërimit të datës 01.07.2024 mban pozitën Drejtor i Departamentit për Çështje Ligjore/SKGJK-Kryesues i Komisionit, 2. Muhamet Kurtishaj- anëtarë i komisionit, i cili sipas Aktit të Emërimit të datës 01.07.2024 mban pozitën Drejtor i Departamentit të Logjistikës dhe Infrastrukturës, 3. Blerim Batatina- anëtarë i komisionit, i cili sipas Aktit të Emërimit të datës 12.09.2024 mban pozitën Drejtor i Departamentit të Evidencës Qendrore Penale, 4. Zorica Petkoviç-anëtare e komisionit, e cila sipas Aktit të Emërimit të datës 01.07.2024 mban pozitën Ndihmës Administrator i Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega Shtërpce, si dhe 5. Arta Podvorica-anëtare e komisionit, e cila sipas Vendimit të datës 13.03.2025 mban pozitën e Ushtresit të Detyrës së Udhëheqësit të Divizionit të Rekrutimit dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të SKGJK-së, sikurse Kolegji i Këshillit po ashtu konstatoi se anëtar i Komisionit të Pranimit, A.H përmes shkresës së datës 19.11.2025 ka njoftuar organin e punësimit se pjesëmarrja e tij në vlerësimin e testimit me shkrim bie ndesh me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ashtu që i njëjti është zëvendësuar me anëtarin tjetër të Komisionit të Pranimit, B.R- i cili sipas Aktit të Emërimit të datës 01.07.2024 mban pozitën Drejtor i Zyrës për Statistika, nga rrjedh se pretendimi ankimor i ankueses për përbërjen apo themelimin e komisionit përkatës të pranimit nuk është i bazuar.

Nga ajo që u tha si më lartë, Kolegji i Këshillit pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe konstatimeve të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi si dhe duke marr për bazë kuadrin ligjor në fuqi, dispozitat e LPPA-së dhe të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Pranimit, Emërimit dhe Punës Provuese për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor, vendosi që ankesën e ankuesit të datës 29.12.2025 ta refuzoi për arsytet e dhëna si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, pasi u konstatua se procedura përkatëse e pranimit është zhvilluar në pajtim me nenin 3 të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Pranimit, Emërimit dhe Punës Provuese për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor, dhe mbi këtë bazë mbetet në fuqi Formulari i vlerësimit përfundimtar të testit me shkrim dhe intervistës me gojë, të datës 26.11.2025 për pozitën *“Mbikëqyrës i Sektorit për Pranim, Regjistrim, Dorëzim dhe Menaxhim të Lëndëve”* në Gjykatën Themelore në Ferizaj.

Andaj, pas konstatimeve të dhëna si më lart dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë Juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur, e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendim.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.2079/2025, datë 12/02/2026.

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses, V.Z.I;
- Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (Drejtorit të Përgjithshëm dhe Njesisë të Burimeve Njerëzore);
- Arkivit të KPMSHCK-së.